

	<p align="center">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p align="center">Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
---	---	---

Datë/a:	06.04.2022.
Për/ Za/ To:	Operatori Ekonomik: “EL BAU” sh.p.k.
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Nexhmi Mekolli – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/ A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 04.04.2022 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: “EL-BAU” sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Intervenime emergjente - pastrimi i shtratit të lumenjve dhe kanalizimit atmosferik”**, me Nr. të Prok: **616-21-8437-5-2-1** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: “EL-BAU” sh.p.k. e parashtruar me datë: 04.06.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Intervenime emergjente - pastrimi i shtratit të lumenjve dhe kanalizimit atmosferik”, me Nr. të Prok: 616-21-8437-5-2-1, kundër Njoftimit për Vendim për Anulim të aktivitetit të AK -së, të datës 31.03.2023 të publikuar në web-faqe të KRPP-së, në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.**
2. Autoriteti Kontraktues, mbështet vendimin për anulim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Intervenime emergjente - pastrimi i shtratit të lumenjve dhe kanalizimit atmosferik”**, me Nr. të Prok: **616-21-8437-5-2-1**.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Ar sy e t i m

Autoriteti Kontraktues me datë: 31.03.2022 ka bërë publik Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues në sistemin elektronik E-Prokurimi lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull:

“Intervenime emergjente - pastrimi i shtratit të lumenjve dhe kanalizimit atmosferik”, me Nr. të Prok: 616-21-8437-5-2-1

Ju si Operator Ekonomik keni ushtruar të drejtën e juaj për Kërkesë për Rishqyrtim, pra me datë: 06.04.2022.

Andaj në bazë të nenit 731 të Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik – RRUOPP:

31. Validiteti i Tenderit

31.3 përiudha e validitetit të tenderit e specifikuar në dosjen e tenderit do të ndryshoj varësisht nga kompleksiteti i prokurimit. përiudha e kërkuar e validitetit do të jetë jo më shumë se që është e nevojshme, dhe do të jetë e mjaftueshme për AK të bëjë vlerësimin e tenderëve të pranuar dhe të bëjë dhënien dhe nënshkrimin e kontratës.

31.4 Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të përiudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)

31.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohet që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre.

31.6 Është e hapur për secilin OE të vendosë nëse dëshiron të përtërijë validitetin e tenderit apo jo. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si “të papërgjegjshëm” dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre.

I nderuar OE: "EL-BAU" ju nuk keni respektuar me vetëdije të plotë nuk keni respektuar dispozitat e nenit 31 për validitet të sigurimit të tenderit pasi që me datë: 22.02.2022 ju ka ardhur shkresa zyrtare përmes sistemit elektronik E-Prokurimi për vazhdimin e validitetit të sigurimit të tenderit.

Duke pasur parasysh që procedura e prokurimit nuk ka përfunduar si rezultat i paraqitjes së dy kërkesave për rishqyrtim (një nga OE: EL BAU dhe tjetra nga OE: VIA EGNATIA) dhe aprovimit të kërkesës për rishqyrtim të OE: VIA EGNATIA domosdoshmërisht vënë në funksion procesin e ri-vlerësimit me çka vihet në funksion edhe kërkesa për zgjatjen e afatit të sigurimit të tenderit deri në përfundim të procesit të shterimit të afateve kohore për parashtrim të kërkesave për rishqyrtim.

Andaj në bazë të asaj se çka është cekur në arsyetim, Autoriteti Kontraktues ka vendosur si në dispozitivin e lartcekur.

Iu dorëzohet:

*Departamentit të Prokurimit
Palës përmes sistemit elektronik - E-Prokurimi
Arkivit*

ZYRTARI PËRGJEGJËS I PROKURIMIT

